


Indeksi i Çmimeve të Prodhimit

Tremujori IV, 2025

Tiranë, më 05 Mars 2026: Në tremujorin e katërt të vitit 2025, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) arriti 129,6, kundrejt vitit 2021 si periudhë bazë. Indeksi i Çmimeve të Prodhimit shënoi rritje vjetore me 0,2 %.

Fig. 1 Indeksi i Çmimeve të Prodhimit



Rritja më e lartë vjetore u shënuar në seksionet “Industri përpunuese” me 0,5 %, ndjekur nga seksioni “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve” me 0,2 %. Brenda seksionit “Industri përpunuese”, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në aktivitetin “Prodhimi i mobiljeve” me 1,5 % dhe aktivitetin “Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutikë” me 1,4 %. Ndërsa ulja më e madhe e çmimeve vërehet në aktivitetin “Metalurgjia” me 0,6 % dhe dhe aktiviteti “Prodhimi i paisjeve elektrike” me 0,5 %. Nga ana tjetër, seksioni “Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri kondicionuar” shënoi ulje prej 0,4 %, pasuar nga seksioni “Industri nxjerrëse” me 0,2 %.

IÇP për tregun vendas: Shënoi një rritje vjetore prej 0,3 %. Rritja vjetore më e madhe u vu re në seksionin “Industri përpunuese” me 0,8 % dhe në seksionin “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave,mbetjeve” me 0,2 %, ndërsa seksioni “Industri nxjerrëse” shënoi një ulje prej 1,5 %.

IÇP për eksport: Shënoi ulje vjetore prej 0,4 %. Ulja më e madhe vjetore u shënua nga seksioni “Energjia elektrike, gaz, avulli dhe ajri kondicionuar” me 1,8 %, pasuar nga seksioni “Industri përpunuese” me 0,3 % dhe seksioni “Industri nxjerrëse” me 0,2 %. Nga ana tjetër seksioni “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave,mbetjeve” shënoi një rritje prej 0,9 %.

Ndryshimet tremujore:

Në krahasim me tremujorin III-2025, IÇP shënoi një rritje me 0,05 %. Rritja më e madhe vërehet në seksionin “Industri përpunuese” me 0,2 %, pasuar nga seksioni “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave,mbetjeve” me 0,1 %. Nga ana tjetër seksioni “Industri nxjerrëse” shënoi një ulje prej 0,4 %, pasuar nga seksioni “Energjia elektrike, gaz, avulli dhe ajri kondicionuar” me 0,1 %.

IÇP për tregun vendas: Në krahasim me tremujorin e tretë 2025, shënoi një rritje me 0,1 %. Rritja vërehet në seksionin “Industri përpunuese” me 0,3 %, pasuar nga seksioni “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave,mbetjeve” me 0,1 %. Nga ana tjetër seksioni “Industri nxjerrëse” shënoi ulje me 0,4 %.

IÇP për eksport: Krahasuar me tremujorin e tretë 2025, shënoi ulje me 0,3%. Ulja më e madhe vërehet në seksionin “Industri nxjerrëse” me 1,2 %, pasuar nga seksioni “Energjia elektrike, gaz, avulli dhe ajri kondicionuar” me 0,5 % dhe seksioni “Industri përpunuese” me 0,04 %. Nga ana tjetër seksioni “Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave,mbetjeve” shënoi rritje me 0,4 %.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të INSTAT: [Indeksi i Çmimeve të Prodhimit](#)

Metodologjia

INSTAT llogarit dhe publikon:

- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit Gjithsej
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të produkteve për tregun vendas
- Indeksin e Çmimeve të Prodhimit të produkteve për eksport

Fusha e mbulimit:

- Seksioni B - Industri nxjerrëse
- Seksioni C – Industri përpunuese
- Seksioni D - Furnizimi me energji elektrike, gaz e avull dhe me ajër të kondicionuar
- Seksioni E - Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve

Llogaritja e indeksit

Indekset llogariten për çdo produkt të klasifikuar sipas Nomenklaturës së Produkteve (NP 2008) në nivel 6-shifror dhe publikohen sipas degëve të ekonomisë në nivel 2-shifror. Rinovimi i kampionit të ndërmarrjeve dhe shportës së produkteve realizohet çdo vit duke përdorur rezultatet e Anketës Strukturore pranë Ndërmarrjeve Ekonomike jo Bujqësore. Përcaktimi i peshave të produkteve me destinacion tregun vendas mbështetet në rezultatet e po kësaj ankete, ndërsa peshat e produkteve me destinacion eksportin mbështeten në të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme.

Duke filluar nga tremujori i parë 2024 e në vazhdim Indeksi i Çmimeve të Prodhimit ka si periudhë referuese vitin 2021 = 100. Metoda e llogaritjes së indeksit është metoda zinxhir (Laspeyres - chain index) sipas së cilës, çmimi i produktit në periudhën korrente (y) krahasohet me çmimin e muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm (y – 1);

$$I_{korrent}^{y,m} = \frac{100}{\frac{1}{12} \sum_{Dec} I_{Y-1,Dec}^{Y,M}} + \prod_{Y=viti\ bazë}^{y-1} I_{Y-1,Dec}^{Y,M} * I_{y-1,Dec}^{y,m}$$

- Pjesa e parë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve të muajit Dhjetor të vitit të mëparshëm krahasuar me mesataren e çmimeve në vitin bazë.

- Pjesa e dytë e formulës tregon lëvizjen zinxhir të indeksit të çmimeve nga muaji Dhjetor të vitit të mëparshëm deri në periudhën y-1.

- Pjesa e tretë e formulës tregon ndryshimin e çmimeve nga muaji Dhjetor y-1 në muajin m të vitit y.

Matësit e Indeksit

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e çmimit midis tremujorit korrent dhe të njëjtit tremujor të vitit të kaluar. Ky

ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve vjetore në nivelet e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të çdo tremujori. Ndryshimi tremujor krahason nivelet e çmimit të dy tremujorëve të fundit.